



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIJE ANTI CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Nr. i tag Broj. stranica Nr. pages	DPK/DMP 01
Nr. Prot Br. Prot Prot. No Data Datum Date	03-4007/12 06.11.2012
PRISHTINE	



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRISHTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 14852/2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurit Sylejman Sopa nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 5.6 paragrafi 1.2 dhe enni 8 par. 1 dhe 2 te Ligjit nr. 04/L -050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë peronat Zyrtar, e në bazë të nenit 73,74, si dhe neni 198 al.1.pika 8 të LMK-së, me dt.31.10.2012 merr

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtës kundër të lartcekurit Sylejman Adem Sopa i lindur me 1954 ne Bukosh, tani më vendbanim ne Prishtinë ne rrugën Ulpiana rr. Mujë Krasniqi hy. 1/C nr. 15, për kundërvajtje nga 5.6 paragrafi 1.2 dhe enni 8 par. 1 dhe 2 te Ligjit nr. 04/L -050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë peronat Zyrtar

Konform neni 198 al.1 pik. 8 te LMK-es Pezullohet Procedura ,pasi qe nuk ka provë se ka kryer kundërvajtje.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një ekzemplar të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtroi kërkesën nr. 01-16006/2012 të dt.02.05.2011, për zhvillimin e procedurës kundërvajtës kundër të lartpërmendurit e për kundërvajtjen e lartcekur,ku është marr konkluzion.

Ne baze te kërkesës u murr ne pyetje i lartcekuri I cili e mohoj kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, duke deklaruar se ne pozitën te cilën kam qenë në Ministri ku ketë post e kam marrë ne vitin 2009, dhe pas keti posti i kam pas edhe disa lëvizje apo emëtime te tjera në kuadër te Ministrisë , ku kam qenë edhe në postin e sekretariatit te përgjithshme, ku edhe në atë funksion kam qenë deri 24.05.2011, ku nga ky funksion prapë jam kthyer ne funksionin e më parshim, dhe pas këti funksioni është arrit memorandum i mirëkuptim në mes Ministrisë se Drejtësisë dhe Prokurorisë se Shtetit, për transferimin e kompetencave e cila është arrit me dt. 30.09.2011, dhe nga kjo marrëveshje e kam marrë kontratën e punës me nr. 27/PSHK te datës 01.11.2011 me kohëzgjatje deri me 30.09.2013, qe te punoj ne divizionin e shqyrtimin e preformancave te Prokurorëve, dhe nga kjo pozitë jam i obliguar ta paraqes pasurin, ku edhe e kam paraqitë ne agjension. Dua te deklaroj se është një keq kuptim nga personeli i administratës se Ministrisë, ku nuk e kan fshirë emrin tim nga lista, por e ka dërguar të njëjtën listë qe ka qenë disa vite me herët, kjo kërkesë është bërë për shkak te gabimeve qe është leshur nga Ministria e Drejtësisë, gjegjësisht nga pika kontaktuese e kësaj Ministrie me agjensionin Anti Korupsion.

Ne deklarate e dhanë te parashtruesi të Arta Nuredini- Durmishi zyrtare e burimeve njerëzore – devezioni i Burimeve njerëzore Ministria e Drejtësisë, e cila deklaroj se unë e kam dërguar këtë listë të emrave te gjithë personave zyrtar, qe janë te obliguar qe ta paraqesin pasurin ne agjensionin ani Korrupsion, ku në ketë listë ne rastin konkret është i përfshi edhe Sylejman Sopi ne cilësinë e drejtorit te departamentin ne qasje në Drejtësi, ku unë si person kontaktues me agjensionin nuk kam pasur te dhëna nga Prokuroria e Shtetit, se Sylejman Sopa ka kaluar në devizionin e njësitit për shqyrtim te prefomancave së Prokurorëve në pozitën menaxher i zyrës për trajnime te cilën pozitë e kishte marrë në bazë të memorandumit, në mes Ministrisë se Drejtësisë dhe Prokurorisë se Shtetit. dhe ja kam dërguar me imel formularin për plotësim për paraqitjen e pasurisë, ku i njëjti e ka pranua dhe nuk e ka kundërshtuar. Ne fund mund te them se po ta kisha ditë memorandumin dhe kontratën te cilën ju ka dhanë Sylejmanit, nuk do te kishte figura emri i tij në listën e zyrtarëve për deklarimin e pasurisë nga kjo pozitë, ku dhe ju kemi informuar me një shkresë zyrtare te nënshkruar edhe nga sekretari i përgjithshëm Ministrisë se Drejtësisë për ndryshimin e vendit te punës te z. Sylejman Sopit, qe te ju shërbej juve si provë te datës 31.05.2012.

Sipas kërkesës se ushtruar marrjes ne pyetje te pandehurin dhe prova te tjera te administruar ne lëndë, gjyqtari konform neni 198 al.1 pik. 8 te LMK-es e PEZULLOI procedurën kundërvajtje ndaj te lartpërmendurit. pasi qe nuk ka provë se ka kryer kundërvajtje.

KESHILLI JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së lartë për kundërvajtje në Prishtinë brenda 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit përmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

VENDETOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Gjyqtar për kundërvajtje

Amir Behrami

